

ZGJIDH ME MENDJE, JO ME ZAKON

**KRAHASO OFERTAT
POLITIKE**



**VOTO ME DIJE,
JO ME DYSHIM!**

BULETIN INFORMATIV



Përballja e Ofertave Politike: Dialog për Zgjedhje të Informuara

Në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të 11 majit 2025, rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” ka organizuar 7 forume publike në 7 qarqe të Shqipërisë, duke krijuar hapësira të drejtpërdrejta dialogu midis qytetarëve dhe kandidatëve për deputetë.

Këto forume synojnë të nxisin transparencën, llogaridhënien dhe përfshirjen qytetare në proceset vendimmarrëse, duke kontribuar në rritjen e debatit publik dhe orientimin e ofertave politike drejt nevojave të komuniteteve.

Shtrirja e Forumeve POP në Qarqe

Forumet janë zhvilluar në qarqet: Tiranë, Elbasan, Shkodër, Durrës, Fier, Korçë dhe Vlorë, ku rrjeti POP operon.

Forumi në Kukës nuk u realizua për shkak të mungesës së vullnetit të subjekteve politike konkurruese për të marrë pjesë.



RRETH ORGANIZIMIT TË FORUMEVE PUBLIKE

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të nxisë debatin publik dhe të forcojë transparencën në proceset zgjedhore, duke krijuar hapësira të drejtpërdrejta komunikimi midis qytetarëve dhe kandidatëve për deputetë. Përmes organizimit të forumeve publike në qarqet ku është aktiv, rrjeti kontribuon në rritjen e aksesit në informacion dhe orientimin e platformave politike drejt nevojave të komunitetit.

Në funksion të këtij qëllimi, rrjeti POP i ka drejtuar ftesa zyrtare për pjesëmarrje në forume të gjitha forcave politike, si ato kryesore ashtu edhe subjektet më të vogla, për të garantuar përfaqësim dhe përballje të barabartë. Për fat të keq, mungesa e disa prej tyre mbetet një fakt shqetësues, duke reflektuar një mungesë vullneti për t’u përfshirë në një dialog të hapur me qytetarët. Një pjesëmarrje e plotë do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një kulture demokratike të mirëfilltë, ku transparenca dhe llogaridhënia nuk janë zgjedhje, por detyrim ndaj publikut.

Forumet publike u zhvilluan në format hibrid, duke kombinuar pjesëmarrjen fizike në sallë me transmetimin live në mediat sociale të rrjetit POP, çka ka mundësuar një akses më të gjerë për publikun. Në total, 530 qytetarë morën pjesë fizikisht në sallat e forumeve, ndërsa përmes transmetimeve online, forumeve u janë bashkuar mbi 23,000 qytetarë, të cilët i kanë ndjekur diskutimet në kohë reale ose më pas në platformat digjitale.

Në këto forume u angazhuan gjithsej 41 kandidatë për deputetë nga forca të ndryshme politike, të cilët iu përgjigjën pyetjeve të qytetarëve, prezantuan prioritetet e tyre dhe u përfshinë në diskutime të hapura mbi temat më të rëndësishme për komunitetet lokale.

Kërkesa për një politikë më të përgjegjshme, përfshirëse dhe të orientuar drejt qytetarit është në përputhje të plotë me parimet themelore të integritetit evropian. Forumet POP treguan se qytetarët janë të vetëdijshëm për rolin e tyre në forcimin e demokracisë dhe presin që përfaqësuesit politikë të veprojnë në përputhje me standardet e një qeverisjeje të hapur dhe pjesëmarrëse. Kjo nuk është vetëm një nevojë e brendshme për demokraci funksionale, por edhe një kusht thelbësor në rrugën e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.



**ZGJIDH ME
MENDJE,
JO ME
ZAKON**
**KRAHASO OFERTAT
POLITIKE**

Shoqata “Tjetër Vizion”

Forumi Publik POP Elbasan

Forumi Publik në Elbasan u zhvillua më 17 prill 2025, në bashkëpunim me organizatën partnere “Tjetër Vizion”, duke sjellë përballë qytetarëve kandidatët për deputetë të qarkut.

Në forum morën pjesë rreth 60 qytetarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme shoqërore, të rinj, të moshuar dhe aktorë lokalë.

Diskutimet u fokusuan në tema kyçe si: zhvillimi ekonomik dhe punësimi, mbrojtja e mjedisit, arsimi profesional, përfshirja e të rinjve, transparencja, dhe lufta kundër korrupsionit. Qytetarët adresuan pyetje mbi integrimin në BE, punësimin në bujqësi dhe artizanat, përfshirjen e grave në zonat rurale, si dhe financimin e fushatave zgjedhore.

[Lexoni më shumë](#)



Kandidatët që pranuan ftesën

- **Znj. Klodjana Capja** – Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore”
- **Z. Mivan Peci** – Partia “Lëvizja Bashkë”
- **Znj. Migena Shyti Kapllani** – Koalicioni Euroatlantik
- **Znj. Lindita Kabila** – Nisma “Shqipëria Bëhet”
- **Znj. Sara Zekaj** – Partia “Mundësia”
- **Z. Erjon Murataj** – Partia Social Demokrate



Ndiqni forumin e plotë



Çështjet kryesore të diskutuara nga qytetarët

Forumi Publik POP Elbasan krijoi një hapësirë të vlefshme për qytetarët që të drejtonin pyetje të drejtpërdrejta kandidatëve, duke prekur tema të ndjeshme dhe me rëndësi të lartë për komunitetin. Ndër çështjet e diskutuara ishin:

- Mundësitë për të rinjtë pas përfundimit të studimeve në Shqipëri;
- Përfitimet e qytetarëve nga integrimi në BE;
- Planet konkrete për punësimin në sektorët bujqësorë dhe artizanat;
- Masat për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Elbasan;
- Politikat për përfshirjen e grave dhe vajzave në zonat rurale;
- Transparenca financiare e partive gjatë fushatës zgjedhore.

18 PRILL 2025

QARKU SHKODËR

Shoqata Intelektualët e Rinj Shpresë

Forumi Publik POP Shkodër

Forumi Publik në Shkodër u zhvillua më 18 prill 2025, në bashkëpunim me organizatën partnere Intelektualët e Rinj Shpresë, duke sjellë përballë qytetarëve kandidatët për deputetë të qarkut.

Në forum morën pjesë rreth 80 qytetarë, të cilët përfaqësonin kategori të ndryshme të shoqërisë, përfshirë të rinj, përfaqësues të shoqërisë civile, profesionistë të ndryshëm dhe qytetarë të zakonshëm të angazhuar në çështje komunitare.

Diskutimet u fokusuan në tema kyçe si: Arsimi dhe lidhjen e tij me tregun e punës; Infrastruktura rrugore dhe nevojat për investime; Ekonomia lokale dhe nxitja e punësimit etj.

[Lexoni më shumë](#)



Kandidatët që pranuan ftesën

- **Z. Tedi Kopliku** – Aleanca për Shqipërinë Madhështore
- **Z. Gabriel Rakaj** – Lëvizja Bashkë
- **Z. Franc Shkëmbi** – Koalicioni Euroatlantik
- **Znj. Kejsi Spahia** – Partia Socialiste
- **Z. Amel Pervezi** – Nisma "Shqipëria Bëhet"
- **Z. Elvis Deda** – Partia "Mundësia"



Ndiqni forumin e plotë



Çështjet kryesore të diskutuara nga qytetarët

Forumi Publik POP në Shkodër u shndërrua në një mundësi konkrete për qytetarët që të angazhoheshin drejtpërdrejt me kandidatët për deputetë, duke adresuar pyetje dhe shqetësime mbi çështje thelbësore për jetën e përditshme dhe zhvillimin lokal. Diskutimet u fokusuan në temat më të ndjeshme dhe me prioritet për komunitetin shkodran si: Mundësitë për të rinjtë pas përfundimit të studimeve në Shqipëri;

- Arsimi dhe lidhja e tij me tregun e punës
- Infrastruktura rrugore dhe nevojat për investime
- Ekonomia lokale dhe nxitja e punësimit
- Potenciali i turizmit dhe sfidat për zhvillim të qëndrueshëm
- Bujqësia dhe nevoja për mbështetje të fermerëve
- Politikat e mbështetjes sociale për grupet në nevojë

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Forumi Publik POP Tiranë

Forumi Publik në Tiranë u zhvillua në bashkëpunim me organizatën partnere Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”(GADC), duke sjellë përballë qytetarëve kandidatët për deputetë të qarkut në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare 2025.

Në forum morën pjesë rreth 110 qytetarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme shoqërore, përfshirë të rinj, përfaqësues të komuniteteve, pensionistë, aktivistë etj.

Diskutimet u fokusuan në tema si: zhvillimi ekonomik, përfaqësimi i të rinjve, transparencja dhe lufta kundër korrupsionit; arsimit dhe integrimi evropian; përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje; angazhimet për grupet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane; lehtësirat për pensionistët etj.

[Lexoni më shumë](#)



Kandidatët që pranuan ftesën

- **Z. Jonathan Pano** - Aleanca për Shqipërinë Madhështore
- **Znj. Bora Mema**- Partia Lëvizja Bashkë
- **Znj. Diana Toma** - Koalicioni Euroatlantik
- **Z. Erion Malaj** - Partia Socialiste
- **Znj. Dorina Prethi** - Nisma Shqipëria Bëhet
- **Znj. Elena Kocaqi** - Aleanca Kombëtare Shqiptare
- **Znj. Barbara Doda** - Partia Mundësia
- **Z. Dritan Idrizi** - Partia Social Demokrate



Ndiqni forumin e plotë



Çështjet kryesore të diskutuara nga qytetarët

Forumi Publik POP në Tiranë ofroi një hapësirë të drejtpërdrejtë ndërveprimi mes qytetarëve dhe kandidatëve për deputetë, duke i dhënë qytetarëve mundësinë të shprehnin shqetësimet e tyre dhe të kërkonin angazhime konkrete për sfidat që prekin jetën sociale dhe ekonomike të komunitetit. Diskutimet u përqendruan në çështje kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm të qarkut, si:

- Zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të reja të punës,
- Përfaqësimi i të rinjve në proceset vendimmarrëse,
- Përmirësimi i sistemit arsimor dhe integrimi evropian,
- Lufta kundër korrupsionit dhe rritja e transparencës,
- Përfshirja e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane,
- Mbështetja sociale për pensionistët dhe grupet e marginalizuara.

Gruaja në Zhvillim Korçë

Forumi Publik POP Korçë

Forumi Publik në Korçë u zhvillua në bashkëpunim me organizatën partnere Gruaja në Zhvillim Korçë, duke sjellë përballë qytetarëve kandidatët për deputetë të qarkut në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare 2025.

Në forum morën pjesë rreth 65 qytetarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme shoqërore, përfshirë të rinj, përfaqësues të komuniteteve, pensionistë, aktivistë, gazetarë etj.

Gjatë forumit, kandidatët prezantuan prioritetet e tyre elektorale dhe u përballën me pyetje konkrete nga qytetarët mbi çështje kyçe si: Zhvillimi ekonomik; Barazia gjinore; Përfaqësimi i të rinjve; Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit.

Lexoni më shumë



Ndiqni forumin e plotë



Kandidatët që pranuan ftesën

- **Z. Petro Lubonja** - Lëvizja Bashkë
- **Znj. Laureta Alidinaj Besholli** - Koalicioni Euroatlantik
- **Z. Klajdi Pllaha** - Koalicioni Nisma Shqipëria Bëhet
- **Z. Ilirian Agolli** - Partia Mundësia

Çështjet kryesore të diskutuara nga qytetarët

Forumi Publik POP në Korçë krijoi një platformë të hapur për dialog mes qytetarëve dhe kandidatëve për deputetë, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të adresonin sfida konkrete dhe të kërkonin angazhime të qarta mbi çështje me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre. Diskutimet u fokusuan në temat të ndryshme si:

- Përfshirja e qytetarëve në hartimin e politikave edukative dhe programore të partive,
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore,
- Shfrytëzimi i potencialit të energjive të rinovueshme (p.sh. projekti i gazsjellësit),
- Lufta kundër informalitetit ekonomik,
- Mbështetja për gratë e divorcuara dhe nënat e reja,
- Nxitja e kthimit të të rinjve nga emigracioni përmes investimeve dhe zhvillimit lokal.

Qendra Rinore e Vlorës

Forumi Publik POP Vlorë

Forumi Publik në Vlorë u zhvillua në bashkëpunim me organizatën partnere Qendra Rinore e Vlorës, duke sjellë përballë qytetarëve kandidatët për deputetë të qarkut në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare 2025.

Në forum morën pjesë rreth 54 qytetarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme shoqërore, përfshirë të rinj, aktivistë, gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe vëzhgues ndërkombëtarë.

Gjatë forumit, kandidatët prezantuan platformat e tyre politike dhe diskutuan me qytetarët mbi çështje me rëndësi për komunitetin lokal, si: punësimi, shërbimet publike, mjedisi, arsimi, si dhe transparenca dhe lufta kundër korrupsionit.

Lexoni më shumë



Ndiqni forumin e plotë



Kandidatët që pranuan ftesën

- **Znj. Nada Daullja** – Aleanca për Shqipërinë Madhështore
- **Z. Ilir Zoto** – Lëvizja Bashkë
- **Z. Gjergji Nika** – Koalicioni Euroatlantik
- **Znj. Ornela Hila** – Nisma "Shqipëria Bëhet"
- **Z. Luçiano Binaj** – Koalicioni Djathtas për Zhvillim
- **Z. Mallëngjim Skënderaj** – Partia "Mundësia"

Çështjet kryesore të diskutuara nga qytetarët

Forumi Publik POP në Vlorë u kthye në një moment të rëndësishëm dialogu midis qytetarëve dhe kandidatëve për deputetë, duke mundësuar shkëmbim të drejtpërdrejtë mbi çështjet që shqetësojnë komunitetin dhe kërkojnë përgjigje të qarta nga përfaqësuesit politikë. Diskutimet e hapura sollën në vëmendje një sërë temash me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën sociale dhe publike të qytetarëve, përfshirë:

- Sfidat e punësimit dhe përmirësimin e kushteve ekonomike,
- Cilësinë dhe qasjen në shërbime publike,
- Menaxhimin mjedisor dhe ruajtjen e hapësirave natyrore,
- Zhvillimin arsimor dhe rolin e të rinjve në vendimmarrje,

Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Forumi Publik POP Durrës

Forumi Publik në Durrës u zhvillua në bashkëpunim me organizatën partnere Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – CSDC Durrës, duke sjellë përballë qytetarëve kandidatët për deputetë të qarkut në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare 2025.

Në forum morën pjesë rreth 97 qytetarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme të shoqërisë, përfshirë të rinj, aktivistë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë të angazhuar. Gjatë forumit, kandidatët prezantuan vizionin e tyre politik dhe u përfshinë në diskutime mbi sfida konkrete që prekin komunitetin, si: bujqësia dhe mungesa e subvencioneve, procesi i legalizimeve, emigrimi i të rinjve, cilësia e shërbimeve shëndetësore, pensionet dhe fenomeni i korrupsionit.

[Lexoni më shumë](#)



Ndiqni forumin e plotë



Kandidatët që pranuan ftesën

- **Z. Nazmi Shuli** – Koalicioni Euroatlantik
- **Znj. Redinela Beqiraj** – Koalicioni “Shqipëria Bëhet”
- **Z. Rezart Kthupi** – Koalicioni “Djathtas për Ndryshim”
- **Znj. Jonida Çeçe** – Partia “Mundësia”
- **Z. Artan Kaçani** – Lëvizja “Bashkë”

Çështjet kryesore të diskutuara nga qytetarët

Forumi Publik POP në Durrës shërbeu si një hapësirë e drejtpërdrejtë ndërveprimi mes qytetarëve dhe kandidatëve për deputetë, duke ofruar mundësinë për të ngritur problematika konkrete dhe për të kërkuar angazhime reale nga përfaqësuesit politikë. Gjatë diskutimeve u trajtuan çështje të ndjeshme dhe të përsëritura nga komuniteti, të cilat lidhen me:

- Gjendjen e sektorit bujqësor dhe mungesën e mbështetjes për zonat rurale,
- Procesin e legalizimit të banesave të vjetra dhe pasiguritë ligjore që ai sjell,
- Largimin e të rinjve për shkak të mungesës së perspektivës në arsim dhe punësim,
- Cilësinë dhe aksesin në shërbime shëndetësore publike,
- Vështirësitë e pensionistëve për të përballuar jetesën,

Qendra Epoka e Re

Forumi Publik POP Fier

Forumi Publik në Fier u zhvillua në bashkëpunim me organizatën partnere Qendra “Epoka e Re” Fier, duke sjellë përballë qytetarëve kandidatët për deputetë të qarkut në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare 2025.

Në forum morën pjesë rreth 65 qytetarë, përfaqësues të organizatave mjedisore, grupeve rinore, qytetarë me aftësi të kufizuara, përfaqësues të moshës së tretë dhe aktorë të shoqërisë civile.

Gjatë forumit, kandidatët paraqitën prioritetet e tyre politike dhe u angazhuan në diskutime mbi çështje që prekin drejtpërdrejt komunitetin lokal, si: mbështetja për personat me aftësi të kufizuara, ndotja e Lumit Gjanica dhe problematikat mjedisore, përfshirja e arsimit në programet politike, angazhimi për rininë dhe sfidat që lidhen me transparencën dhe korrupsionin.

[Lexoni më shumë](#)



Ndiqni forumin e plotë



Kandidatët që pranuan ftesën

- **Z. Fation Semanjaku** – Aleanca për Shqipërinë Madhështore
- **Z. Elis Baba** – Lëvizja Bashkë
- **Z. Gerald Komini** – Koalicioni Euroatlantik
- **Z. Erion Muska** – Nisma “Shqipëria Bëhet”
- **Znj. Frida Mavriqi** – Partia “Mundësia”
- **Znj. Hava Hoxhaj** – Partia Social Demokrate

Çështjet kryesore të diskutuara nga qytetarët

Forumi Publik POP në Fier krijoi një hapësirë të drejtpërdrejtë ndërveprimi mes qytetarëve dhe kandidatëve për deputetë, duke i dhënë komunitetit mundësinë të adresojë shqetësime konkrete dhe të kërkojë përgjigje të qarta nga përfaqësuesit politikë. Diskutimet u përqendruan në çështje me rëndësi të veçantë për jetën sociale dhe mjedisore të qytetarëve, si:

- Mungesa e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja për politika përfshirëse,
- Përfshirja e arsimit në prioritetet programore të partive,
- Ndotja e Lumit Gjanica dhe mungesa e masave për mbrojtjen e mjedisit,
- Sfidat e të rinjve për punësim dhe përfaqësim aktiv,
- Lufta kundër korrupsionit dhe rritja e transparencës në qeverisje.

FORUMET PUBLIKE: DOMOSDOSHMERI, JO ALTERNATIVE

Në përfundim të shtatë forumeve publike të organizuara në qarqet Tiranë, Elbasan, Shkodër, Durrës, Fier, Korçë dhe Vlorë, Rrjeti POP ka identifikuar disa çështje kyçe dhe prioritetet që u përsëritën nga qytetarët dhe u reflektuan në diskutimet me kandidatët për deputetë:

Nevoja për punësim dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm

Në të gjitha qarqet u theksua mungesa e mundësive të punësimit, veçanërisht për të rinjtë, gratë dhe banorët e zonave rurale. Qytetarët kërkuar më shumë mbështetje për bujqësinë, artizanatin, turizmin dhe iniciativat lokale.

Shërbime publike cilësore dhe të qasshme

Problematikat e lidhura me legalizimet, shëndetësinë, arsimin dhe pensionet ishin të pranishme në të gjitha forumet. Kërkesa për reforma dhe shërbime më efektive u ngrit me forcë nga komuniteti.

Përfshirja e grupeve në nevojë

Qytetarët kërkuar politika të drejta dhe efektive për persona me aftësi të kufizuara, gratë të vetme, pensionistë dhe të rinj pa akses në shërbime dhe mundësi zhvillimi.

Demokraci funksionale dhe rritje të transparencës

Në disa qarqe, mungesa e disa partive politike të ftuara në forume u perceptua si një mungesë vullneti për t'u përballur me qytetarët. Kjo thekson nevojën për një kulturë politike më të hapur, të përgjegjshme dhe të gatshme për llogaridhënie.

Mbrojtja e mjedisit dhe qëndrueshmëria

Çështje të ndotjes së lumenjve, keqmenaxhimit të mbetjeve dhe pasivitetit institucional në ruajtjen e hapësirave natyrore ishin të pranishme në disa qarqe dhe u kërkuar ndërhyrje urgjente.

Zëri i qytetarëve ka rëndësi

Forumet POP treguan se qytetarët janë të gatshëm të angazhohen kur u krijohet hapësira për të pyetur, për të marrë përgjigje dhe për të ndikuar në vendimmarrje. Ballafaqimi publik me kandidatët përbën një mjet të rëndësishëm për forcimin e demokracisë pjesëmarrëse.

Forumet POP treguan se një demokraci funksionale dhe gjithëpërfshirëse nuk është vetëm aspiratë e brendshme, por edhe pjesë e angazhimeve që Shqipëria ka marrë në rrugën drejt integritit evropian.



**ZGJIDH ME
MENDJE,
JO ME**

Ky buletin u përgatit në kuadër të projektit: "Rrjeti POP për Qeverisje të Mirë dhe Integritet" mbështetur nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Olof Palme International Center.

Organizatat partnere të Rrjetit POP:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", Tiranë
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër
- Qendra Rinore Vlorë
- Qendra "Epoka e Re", Fier
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë
- Qendra për Progres Rinor, Kukës
- Gruaja në Zhvillim, Korçë
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës
- Tjetër Vizion, Elbasan

Për më shumë informacion:

<https://popnetwork.al/>

✉ info@popnetwork.al

☎ +355 69 61 20 169

📍 Rr. "Abdyl Frasheri" Pall 10/1 Tiranë, Shqipëri

